



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KONKURENCËS  
KOMISIONI I KONKURENCËS**

Nr. 106/Prot.  
10

Datë 06.10.2022

**VENDIM**

Nr. 913, Datë 06.10.2022

**“Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit dhe tregtimit të betonit në qarkun e Tiranës, Durrësit dhe Elbasanit”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 06.10.2022, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Hapja e hetimit paraprak në tregun e prodhimit dhe tregtimit të betonit, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.

**Bazë ligjore:** Neni 24, shkronja (d), neni 26 dhe neni 42, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (Ligji nr. 9121/2003).

**Komisioni i Konkurrencës** pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës “Mbi monitorimin e tregut të prodhimit dhe tregtimit të betonit”,

**VËREN SE:**

1. Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës në zbatim të nenit 28 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ka zhvilluar procedurën e monitorimit të tregut të prodhimit të betonit, me qëllim evidentimin nëse ka apo jo shenja të kufizimit, shprehimit apo pengimit të konkurrencës në këtë treg.
2. Për mbledhjen e të dhënave të nevojshme për monitorimin, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, janë kërkuar të dhëna dhe informacion nga: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.
3. Nga procedura e monitorimit të tregut të prodhimit dhe shitjes me shumicë të produktit beton në qarkun e Tiranës u konstatua një numër i madh ndërmarrjesh të cilat operojnë në këtë treg. Pjesa më e madhe e ndërmarrjeve të cilat ushtrojnë veprimtari në tregun e prodhimit të betonit janë ndërmarrje ndërtuese duke e përdorur produktin beton si lëndë e pare për qëllimin e aktivitetit të tyre në fushën e ndërtimit.
4. Nga monitorimi i realizuar konstatohet se:
  - disa nga ndërmarrjet konkurrense kanë marrëdhënie tregtare me njëri-tjetrin lidhur me plotësimin e nevojave për furnizim;

- rritja e çmimit të betonit në të gjitha ndërmarrjet ka ndodhur në të njëjtën kohë në periudhën shkurt-mars të vitit 2022 dhe në të njëjtën masë rreth 30%.
  - çmimet e shitjes së produktit beton ndërmjet ndërmarrjeve janë të përafërta sipas kategorive të betonit.
5. Për sa më sipër, çmimet e përafërta të shitjes së ndërmarrjeve prodhuese të betonit, rritja në të njëjtën periudhë, homogjeniteti i produktit dhe transparenca e tregut, marrëdhëniet tregtare ndërmjet konkurrentëve në këtë treg janë elementë të cilët mund të çojnë drejt një sjellje të bashkërenduar ndërmjet ndërmarrjeve në qarkun e Tiranës, Durrësit dhe Elbasanit, sjellje e cila mund të përbëjë një kufizim, shtrembërim apo pengim të konkurrencës në kuptim të nenit 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

### PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4 dhe 9, nenin 24 shkronja (d), dhe nenin 42, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,


### VENDOSI:

- I. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit dhe tregtimit të betonit në qarkun e Tiranës, Durrësit dhe Elbasanit, për të parë nëse ka, ose jo, shkelje të nenit 4 dhe 9, të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar.
- II. Hetimi paraprak të përfshijë periudhën kohore nga 1 Janar 2020 deri në 30 shtator 2022.
- III. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 3 (tre) muaj nga marrja e këtij vendimi.
- IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


### KOMISIONI I KONKURRENCËS

**Leida MATJA**




Zv/Kryetar

**Rezana KONOMI**




Anëtar

**Adriana BERBERI**



Anëtar

**Durim KRAJA**



Anëtar

